

LIGJ
Nr. 63/2016

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 171/2014, “PËR PËRFUNDIMIN E
PROCEDURAVE TË KALIMIT TË TOKËS BUJQËSORE TË ISH-NDËRMARRJEVE
BUJQËSORE NË PRONËSI
TË PËRFITUESVE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:**

Në ligjin nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, bëhet ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 6, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Afati për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve mbyllet në datën 31 dhjetor 2017.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.6.2016

**Shpallur me dekretin nr. 9642, datë 14.6.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**